



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 810/4 prot.

Tiranë, më 03.12.2025

V E N D I M

Nr. 57, datë 03.12.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, SË
VEPRIMEVE ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË PROCESIT TË ECURISË
DISIPLINORE, NË INSTITUCIONIN E MINISTRISË SË FINANCAVE**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore ndaj nëpunëses Kaltra Selami, në institucionin e Ministrisë së Financave,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është regjistruar informacioni i dërguar me shkresën nr. 810 prot., datë 16.9.2025, nga nëpunësja Kaltra Selami, me detyrë “Drejtor”, i Drejtorisë Mbështetëse të Zyrtarit Kombëtar Autorizues (DMZKA), në Ministrinë e Financave, në të cilin ngrihen pretendimet për parregullsi të kryera gjatë zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, në ngarkim të saj.

Në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, parashtrohet se në ngarkim të nëpunëses ka filluar procesi i ecurisë disiplinore. Në kuadër të këtij procesi, Komisioni Disiplinor me Vendim të Ndërmjetëm nr. 11427/8 prot., datë

31.7.2025, ka vendosur pezullimin nga detyra për nëpunësen Kaltra Selami, deri në përfundim të hetimit dhe marrjen e vendimit përfundimtar nga ky organ disiplinor.

Në përfundim të procedurës disiplinore, Komisioni Disiplinor me vendimin nr. 11427/49 prot., datë 15.9.2025, ka vendosur masën disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, për nëpunësen Kaltra Selami.

Referuar sa më lart, nëpunësja ngre pretendime për parregullsi të lejuara gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore në ngarkim të saj, të cilat kanë të bëjnë me: **a)** mungesën e njoftimit brenda afateve për fillimin e ecurisë disiplinore; **b)** kapërcim të kompetencave të zyrtarit që ka iniciuar procedurën disiplinore; **c)** shkelje të kryera nga ana e Komisionit Disiplinor, gjatë marrjes së “*Vendimit të Ndërmjetëm*” për pezullimin e nëpunëses; si dhe **d)** mosrespektim të hapave proceduralë gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore, në përfundim të së cilës Komisioni Disiplinor ka vendosur “*Largim nga shërbimi civil*” për nëpunësen.

Në këto rrethana, nëpunësja parashtro se, shkeljet disiplinore në ngarkim të saj nuk qëndrojnë dhe nuk janë të provuara, për këtë arsye, ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit, me detyra specifike gjatë realizimit të procesit të ecurisë disiplinore.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me informacionin e dërguar nga nëpunësja, në mbështetje të kompetencave ligjore të sanksionuara në ligjin nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka filluar verifikimin e tij dhe nëpërmjet shkresës nr.810/1 prot., datë 13.10.2025 “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të ardhur nga nëpunësja Kaltra Selami, për nisjen e procedurës disiplinore në ngarkim të saj*”, ka vënë në dijeni institucionin për fillimin e këtij procesi, duke i kërkuar dokumentacionin e nevojshëm në të cilin materializohen veprimet administrative të kryera gjatë procedurës disiplinore.

Në përgjigje të kësaj kerkese, me shkresën nr. 810/2 prot., datë 22.10.2025 “*Kthim përgjigje*”, institucioni i Ministrisë së Financave ka dërguar dokumentacionin e kërkuar dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit që pasqyron veprimet administrative të kryera gjatë procedurës së ecurisë disiplinore, rezulton se:

Zv/Ministri i Financave, në cilësinë e Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA), i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, si eprori direkt për Drejtorët e Drejtorive, me relacionin nr. 11407 prot., datë 27.7.2025, në përmbajtje të së cilit janë parashtruar fakte mbi mosrealizimin, shmangien apo mospërmbushje të detyrave funksionale nga ana e nëpunëses Kaltra Selami, si dhe moskoordinim me strukturën menaxhuese të ZKA. Për gjithë sa më sipër, Zyrtari Kombëtar Autorizues ka kërkuar vlerësimin e situatës, duke kërkuar në të njëjtën kohë edhe fillimin e ecurisë disiplinore.

Pasi është njohur me përmbajtjen e këtij relacioni, Sekretari i Përgjithshëm, si nëpunësi më i lartë civil në institucion, njëkohësisht, në cilësinë e eprorit të drejtpërdrejtë të nëpunëses Kaltra Selami, ka marrë në shqyrtim rrethanat e paraqitura në relacionin e Zv/Ministrit të Financave dhe me shkresën nr. 11427 prot., datë 28.7.2025 “*Relacion i eprorit të drejtpërdrejtë – Vlerësim paraprak dhe vendimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj znj. Kaltra Selami, “Drejtor” i Drejtorisë Mbështetëse të Zyrtarit Kombëtar Autorizues, në Ministrinë e Financave*”, ka vlerësuar se, gjetjet e konstatuara klasifikohen si shkelje të rënda/shumë të rënda dhe për këtë arsye ia ka kaluar çështjen për kompetencë Komisionit Disiplinor.

Komisioni i Disiplinës, i ngritur me urdhrin nr. 95, datë 23.7.2025, të Ministrit të Financave “*Për krijimin e Komisionit të Përleshëm Disiplinor pranë Ministrisë së Financave*”, i ndryshuar me Urdhrin nr. 104, datë 29.7.2025, të Ministrit, për zëvendësimin e Kryetarit të Komisionit Disiplinor (*për shkak të konstatimit të konfliktit të interesit në këtë rast, u bë zëvendësimi i Kryetarit të Komisionit Disiplinor*), pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e administruar, ka vlerësuar se materialet e depozituara krijojnë dyshimin për shkelje disiplinore, e në këto rrethana, ka lindur nevoja për kryerjen e hetimit administrativ dhe sqarimin e rrethanave faktike për nxjerrjen e përgjegjësi administrative të nëpunëses në fjalë. Për këtë arsye, ky organ ka vendosur fillimin e ecurisë disiplinore për nëpunësen Kaltra Selami për shkeljet e pretenduara, si dhe njoftimin e saj për këtë vendim (*shkresa nr.11427/9 prot., datë 31.7.2025, “Njoftim për fillimin e ecurisë disiplinore”*).

Me qëllim hetimin sa më të plotë të rastit, garantimin e të drejtës së nëpunëses për t’u njohur me dokumentacionin, si dhe shmangien e mundësisë për të penguar apo ndikuar në procesin disiplinor dhe mbledhjen e provave, Komisioni Disiplinor ka vlerësuar si të arsyeshëm marrjen e Vendimit të Ndërmjetëm nr. 11427/8 prot., datë 31.7.2025, nëpërmjet të cilit ka vendosur pezullimin nga detyra për nëpunësen Kaltra Selami, deri në përfundim të hetimit dhe marrjen e vendimit përfundimtar.

Në vijim, siç rezulton nga përmbajtja e procesverbaleve dhe shkresave të hartuara gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore nga Komisioni Disiplinor, ndër të cilat: procesverbali nr.11427/11 prot., datë 8.8.2025; shkresa nr.11427/13 prot., datë 11.8.2025 “*Mbi mosparaqitjen në Komisionin Disiplinor për arsye shëndetësore*”, procesverbali nr.11427/14 prot., datë 25.8.2025; procesverbali nr.11427/27 prot., datë 27.8.2025; procesverbal nr. 11427/35 prot., datë 29.8.2025; procesverbal nr. 11427/36 prot., datë 1.9.2025; vendim nr. 11427/37 prot., datë 1.9.2025 “*Për shtimin e objektit të procedimit*”, i Komisionit Disiplinor; shkresa nr. 11427/38 prot., datë 1.9.2025 “*Njoftim për zhvillimin e seancës dëgjimore*”; procesverbali nr. 11427/39 prot., datë 4.9.2025; vendimi nr. 11427/41 prot., datë 4.9.2025 “*Për shtimin e objektit të procedimit*”, i Komisionit Disiplinor; procesverbali nr.11427/44 prot., datë 9.9.2025, Vendimi i Ndërmjetëm nr. 11427/45 prot.,

datë 9.9.2025, i Komisionit Disiplinor, si dhe deklarata të nëpunësve që kanë dijeni të drejtpërdrejtë mbi faktet dhe rrethanat e çështjes në shqyrtim.

Në përfundim të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të mbledhura për shkeljen disiplinore të pretenduar, Komisioni i Disiplinës ka çmuar se shkeljet e kryera nga nëpunësja përbëjnë “shkelje shumë të rëndë” të disiplinës në shërbimin civil, prandaj bazuar në nenin 57, pika 2, germat a), b) dhe c), në nenin 58, germa ç), të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me Vendimin nr. 11427/49 prot., datë 15.9.2025, ka vendosur masën disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, për nëpunësen Kaltra Selami.

Ndërkohë, në vijim të komunikimit me institucionin e Ministrisë së Financave, me anë të postës elektronike, e-mailin e datës 25.11.2025, institucioni ka informuar Komisionerin se, me të njëjtin objekt: “Kundërshtim i masës disiplinore të dhënë nga Komisioni i Disiplinës”, nëpunësja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, proces i cili është në vazhdim, çka provohet me Njoftimin nr. 11158, datë regjistrimi 3.11.2025, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kërkesëpadinë e paditëses K. Selami, të Ministrisë së Financave.

Për sa më sipër, në bazë të përcaktimit në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile” i ndryshuar, në përmbajtje të së cilit sanksionohet se, asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund të trajtojë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se, Komisioneri nuk mund të vijojë më tej, procedurën e hetimit të këtij rasti, pasi kjo mosmarrëveshje është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor, në përfundim të së cilit do të japet zgjidhje përfundimtare pas trajtimit në themel të rastit.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të nenit 90, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes së filluar kryesisht në mbështetje të informacionit të përcjellë me shkresat nr. 810 prot., datë 16.9.2025, dërguar nga nëpunësja Kaltra Selami, pasi mosmarrëveshja është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe do të zgjidhet në themel nga gjykata kompetente.

2. Të njoftohet për këtë vendim Ministria e Financave, si dhe nëpunësja Kaltra Selami.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha